

Data _____

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje kite , reagente e materiale konsumi per labororet fiziko- kimik e bakterologjik ” te Njesise Vendore Kujdesit Shendetesor Kavaje.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Kite e Reagente **33696300-8**

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: : **1 666 369.33 (njemilon e gjashteqind e gjashtedhete e gjashtemije e treqind e gjashtedhete e nente pike tridhete e tre) leke pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar , të nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Njesia Vendore e Kujdesit Shendetesor Kavaje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi:Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“ të ndryshuar, në të cilën është parashikuar se: *1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*

2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

b. Lista e çmimeve të artikujve, sipas Shtojcës 2;

Argumentimi:*Kjo shtojcë është pjesë e setit të dokumenteve standarte të tenderit për procedurën e prokurimit të sipërcituar.*

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Argumentimi:Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik“ te ndryshuar , dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga*

autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos u vendos bazuar në nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik“te ndryshuar ku përcaktohet se:*Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, dhe në nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” të ndryshuar.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatën ISO 9001:2015 mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*”ose/dhe ISO 13485:2016 mbi “*Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore*” për artikujt objekt prokurimi (*bazuar në klasifikimin e pajisjes*), të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
- b) Operatori ekonomik ofertues ne rastet kur nuk eshte prodhues i artikujve objekt prokurimi, duhet te paraqese autodeklarate qe furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi eshte i çertifikuar konformstandarteve te cilesiseISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

AK rezervon te drejten per verifikimin e vetedeklarimit ne procesin e vleresimit te dokumentacionit dhe ne rastin kur OE ofertues shpallet fitues, duhet te paraqese certifikaten ne fjale.

- c) Kerkohet Autodeklarate (Deklarate Konformiteti CE/DC) për kite, reagente, materiale konsumi nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat 98/79/EC ose (EU) IVDR 2017/746 ose EU 2016/425 ,ose MDD 93/42/EEC (sipas aplikimit të vlefshmërisë) ose (EU) 2017/745 - MDR, (kur është e aplikueshme), bashkelidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti), sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, ose certifikim FDA. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit.

Argumentimi: Këto kritere të percaktuar ne pikën a) b) dhe c) janë vendosur ne perputhje me pikën 1 të nenit 79të Ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik“, ku përcaktohet se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

Keto kriter gjen mbështetje dhe në pikën 1 të nenit 44 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit Nr. prot.3330, datë 20.03.2018 dhe Nr. Prot.145, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”. Keto kritere janë vendosur që AK të sigurohet që malli që do të ofrohet nga OE të cilet plotësojnë standartet ndërkombëtare dhe kërkesat e cilësisë që kanë lidhje me produktet objekt i kësaj procedure*

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim nga Degatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e tyre të jetë 40% e vlerës së fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale të vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77të Ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik“, te ndryshuar ku përcaktohet se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...], sikursedhenë pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se:*

Pika 1: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

Pika 2/c: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara se

zoterojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në pikën 1 dhe në pikën 2 të nenit 43 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, është parashikuar marzhi maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohe në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, ku përcaktohet shprehimisht se: Pika 2/c: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohë: 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence;”- .

Bazuar në vlerën e fondit limit të përlllogaritur për këtë prokurimi që është nën kufirin e ulët monetar (bazuar në nenin 11, pika 1, gërma b) të RPP-së) ky kriter u vendos në përputhje të plotë me marzhin maksimal të përcaktuar për këtë lloj procedure prokurimi (nën kufirin e ulët monetar për mallra) në rregullat e prokurimit publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohe, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, të VKM 285/2021 “Mbi Rregullat e Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;”-

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohe vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohe vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohe datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohe datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me pikën 4 të nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020“Për Prokurimin Publik“, ku përcaktohet se:“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës..; si dhe me pikën 4 të nenit 40të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: [...] 4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”-

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor për aftësinë të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përpjestim me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **40 %** të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **autorizim nga firma prodhuese ose distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi**, për tregtimin e mallrave objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave, original ose fotokopje e noterizuar.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, ai garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për

njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (ref. Vendimit të KPP nr. 353/2014).

Gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të Rekomandimit Nr.Prot. 3341/1, datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik”.

3. Për të gjithë artikujt ofruar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (*Specifikimet teknike*), të paraqitet Katalogje, ku të përfshihen specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Argumentimi: Këto kriterë janë vendosur në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 dhe 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe me pikën 6/b të nenit 40 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: [...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*

Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së artikujve që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST në Shtojcën 5. Objekti i prokurimit është specifik, dhe impakti që ka finalizimi me sukses i kësaj kontrate është garantimi i cilësisë së artikujve të kërkuar.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për artikujt e kërkuar në formë tabele, ku të plotësohen: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emërtimi i katalogut të artikullit/produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerrë nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet përkatëse për produktet

Argumentimi: Ky kriter është vendosur me qëllim që të identifikohet përmbushja e specifikimeve teknike për artikujt e kërkuar si dhe është në përputhje me pikën 1 të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku përcaktohet se: *1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit,*

sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. Gjithashtu ky kriter është në përputhje me pikën 2 të nenit 40 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “ 2.Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Në këtë kontekst ligjor është kërkuar dhe oferta teknike, me qëllim verifikimin me saktësi dhe lehtësisht të artikujve të ofertuar, specifikimeve teknike të tyre, origjina, konformiteti, etj. me dokumentacionin ligjor, teknik dhe profesional të paraqitur nga ofertuesi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Skicimet, parametrat teknik etj:

| Nr | Emertimi artikujve | Specifikime teknike | Njësia ose/dhe paketimi | Kodi |
|----|-------------------------|---------------------|-------------------------|------|
| 1 | Pjata Agar Gjaku | | cope | |
| 2 | Mueller Hinton Agar | | kg | |
| 3 | Sabourand dextrose agar | | kg | |
| 4 | Metronidazol | | 1x50 disqe | |
| 5 | Fluconazol | | 1x50 disqe | |
| 6 | Econazol | | 1x50 disqe | |
| 7 | Itroconazol | | 1x50 disqe | |
| 8 | Ketocenazol | | 1x50 disqe | |
| 9 | Clotrimazol | | 1x50 disqe | |
| 10 | Miconazol | | 1x50 disqe | |
| 11 | Nystatin | | 1x50 disqe | |
| 12 | Vericonazole | | 1x50 disqe | |
| 13 | Fluorocytisin | | 1x50 disqe | |
| 14 | Cefaclor | | 1x50 disqe | |
| 15 | Cefuroxime axetil | | 1x50 disqe | |
| 16 | Amikacin | | 1x50 disqe | |
| 17 | Cefotaxime | | 1x50 disqe | |
| 18 | Augmentin | | 1x50 disqe | |
| 19 | Ciprofloxacine | | 1x50 disqe | |
| 20 | Ceftriaxone | | 1x50 disqe | |
| 21 | Trimethoprin | | 1x50 disqe | |
| 22 | Azithromycin | | 1x50 disqe | |
| 23 | Nitrofurantoinë | | 1x50 disqe | |
| 24 | Ampicillin | | 1x50 disqe | |

| | | | | |
|----|--------------------------------|--|------------|--|
| 25 | Ceftazidime | | 1x50 disqe | |
| 26 | Levofloxacin | | 1x50 disqe | |
| 27 | Doxycylin | | 1x50 disqe | |
| 28 | Cefazolin | | 1x50 disqe | |
| 29 | Clarithromycin | | 1x50 disqe | |
| 30 | Cefixime | | 1x50 disqe | |
| 31 | Nalidixic acid | | 1x50 disqe | |
| 32 | Norfloxacin | | 1x50 disqe | |
| 33 | Imipenem | | 1x50 disqe | |
| 34 | Oxacillin | | 1x50 disqe | |
| 35 | Test I shpejte HBsAg | Kasete ,Rapid test/Test I shpejte imunokromatografik per percaktimin e antigenit siperfaqesor te hepatitit B ne serum ose plazma | teste | |
| 36 | Test I shpejte HCV | Kasete , Test I shpejte imunokromatografik per zbulimin cilesor te antitropave te Hep C ne serum plazem ose gjak. | teste | |
| 37 | Test I shpejte HIV1+2 | Kasete ,Rapid test/Test I shpejte imunokromatografik per zbulimin e antitropave te HIV1&HIV2 ne gjak dhe ne serum | teste | |
| 38 | Test I shpejte Syphilis | Kasete , Test I shpejte imunokromatografik per percaktimin e syphilis . | teste | |
| 39 | Helico bacter H.Pylori ne fece | Test i shpejt | test | |
| 40 | Fece gjak akult | Test i shpejt | test | |
| 41 | Tuba me kokrriza | Tuba me kokrriza blu 5 ml (12 x 86 mm) | cope | |
| 42 | Tuba te thjeshta | Epruveta plastike 5 ml cilindrike (12 x 75 mm) | cope | |
| 43 | Tuba jeshil | Tuba K3EDTA 1 ml | cope | |
| 44 | Doreza nitrili M | Nitrili , madhesia M, sterile, ngjyre te bardhe | Pako/100 | |
| 45 | Luge per peshim | Spatul-luge metalike pes Spatul-luge metalike peshimi 150mm gjatesia himi 150mm gjatesia | | |
| 46 | Disk Dispenser | I pershtateshem per pjata petri me diameter 90mm dhe | Cope | |

| | | | | |
|----|---|---|--|-----------|
| | | me 8 vende per vendosjen e disqeve | | |
| 47 | Pambuk | | Pako/100 gr | |
| 48 | Alkol | Alkol etilik 90% | liter | |
| 49 | Injection plaster hypoallergenic | 25mm | Pako /100 | |
| 50 | Lastik per marje gjaku | | Cope | |
| 51 | Uje fiziologjik | Sodium Chloride 0.9% 1000ml | liter | |
| 52 | Membrane disc filter | Membrane Filters 47mm 0.45µm Cellulose nitrate White membrane With green grid Sterile | Pjate | |
| 53 | M-ENDO AGAR LES | Per numerimin e koliformeve ne uje me ane te filtrimit me membrane Pjatat te jene 60mm dhe te thata | Pjate | |
| 54 | M-FAECAL COLIFORM AGAR | Per zbulimin dhe numerimin e koliformeve fekale ne uje me ane te filtrimit me membrane Pjatat te jene 60mm dhe te thata | Pjate | |
| 55 | DPD nr 1(per klorin e lire) | Per aparat Aqualytic AL 800 | tablet/100 | 4511050BT |
| 56 | Reagent per percaktimin e nitriteve (0,01-0,5mg/l N) Nitrite LR | Per aparat Aqualytic AL 800 Nr metotes 270 | tablet/100 | 4512310 |
| 57 | Set test per percaktimin e amoniakut (0,01- 0,08mg/l N)te perbere: Vario ammonia salicylate F10 Vario ammonia cyanurate F10 | Per aparat Aqualytic AL 800 Nr metodes 62 | Set test Powder Pack/100 Powder Pack/100 | 4535500 |

| | | | | |
|----|--|---|--|-----------|
| 58 | Set tub test per percaktimin e Nitrateve (1-30 mg/l) te perbere: 1.Vario Nitrate Chromotropic 2. Vario Nitrox Reagent tube | Per aparat Aqualytic AL 800 Nr metodes 265 | set tub test Powder Pack/50 reaktion tube/50 | 4535580 |
| 59 | Reagent per percaktimin e hekurit 0.01 – 0.5 mg/l Fe IRON LR | Per aparat Aqualytic AL 800 Nr metodes 219 | Tablet / 100 | 4515370BT |
| 60 | Reagent per percaktimin e fortesise pergjithshme(2-50 mg/l CaCO ₃) Hardcheck P | Per aparat Aqualytic AL 800 Nr metodes 201 | tablet/100 | 4515661BT |
| 61 | Set test per percaktimin e Aluminit (0.01-0.3 mg/l) Al te perbere : Aluminium No. 1 / No. 2 | Per aparat Aqualytic AL 800 Nr metodes 40 | set test Tablet / per 100 | 4517601BT |
| 62 | Reagent percaktimin e pehashit PH(6.5- 8.4) Phenol Red/ fotometer | Per aparat Aqualytic AL 800 Nr metodes 330 | tablet /100 | 4511770BT |
| 63 | DPD Nr 3 | Per aparat Aqualytic AL 800 | tablet /100 | 4511080BT |
| 64 | Set test per percaktimin e klorureve 0.5 – 25 mg/l Cl ⁻ Set CHLORIDE T1 / T2 | Per aparat Aqualytic AL 800 Nr metodes 90 | Set Tablet / per 100 inclusive stirring rod | 4517741BT |
| 65 | CyA-TEST (Cyanuric acid) 0 – 160 mg/l CyA | Per aparat Aqualytic AL 800 Nr metodes 160 | Tablet / 100 | 4511370BT |
| 66 | Tretesire buferike pH = 7,00 | Tretesire buferike Fosfat pH = 7 me saktesi ± 0,02 ne 25°C | litra | |
| 67 | Solucion per ruajtjen e elektrodes- Potasium Klorur 3M KCl | | ml/250 | 025 160 |
| 68 | Pipete 1 ml | material qelqi volum 1 ml, Klasi A | cope | |
| 69 | Pipete 25 ml | material qelqi volum 25 ml, Klasi A | cope | |

| | | | | |
|----|--|--|-----------|--|
| 70 | Balon i taruar 100 ml | Ballon qelqi borosilikat Vellimi : 100 ml Klasi A Gryke zmerile me tape polyethylene | cope | |
| 71 | Erlenmayer | Zmeril me tape qelqi borosilicato, volum 250 ml | cope | |
| 72 | Leter filtri (për filtrimin e mostrës së ujit) | Leter filtri kualitative, grada 1, forme rrethore me Ø 125mm | cope /100 | |
| 73 | Shishe | Qelqi të errta të pajisura me tapë me pikatore,Volumi 100 ml | cope | |
| 74 | Xham sahati | Material qelqi diametri 100 mm | cope | |

-Afat i skadencës: Duhet të jetë jo më pak se 1(nje) vit nga data e lëvrimit të mallit në magazinën e NJVKSH Kavaje ,me perjashtim të artikujve me afat skadence me të vogël se 1(nje) vit e për to duhet të paraqitet certifikat prodhimi nga prodhuesi .

-Skadencia duhet të jetë e shënuar në ambalazh.

- Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.

- Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara.

- Çdo artikull që do të rezultojë jashtë kërkesave tona,do t'i rikthehet shitesit për të zëvendësuar.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 4,pika 38/b, nenin 36 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar , dhe nenin 40, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Shtojca 6**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT****Sasia e mallit që kërkohet:****Sasia e mallit që kërkohet:**

| Nr | Emertimi artikujve | Njësia ose/dhe paketimi | Sasia |
|-----------|---------------------------|--------------------------------|--------------|
| 1 | Pjata Agar Gjaku | cope | 500 |
| 2 | Mueller Hinton Agar | kg | 1 |
| 3 | Sabourand dextrose agar | kg | 1 |
| 4 | Metronidazol | 1x50 disqe | 3 |
| 5 | Fluconazol | 1x50 disqe | 3 |
| 6 | Econazol | 1x50 disqe | 3 |
| 7 | Itroconazol | 1x50 disqe | 3 |
| 8 | Ketocenazol | 1x50 disqe | 3 |
| 9 | Clotrimazol | 1x50 disqe | 3 |
| 10 | Miconazol | 1x50 disqe | 3 |
| 11 | Nystatin | 1x50 disqe | 3 |
| 12 | Vericonazole | 1x50 disqe | 3 |
| 13 | Fluorocytisin | 1x50 disqe | 3 |
| 14 | Cefaclor | 1x50 disqe | 5 |
| 15 | Cefuroxime axetil | 1x50 disqe | 5 |
| 16 | Amikacin | 1x50 disqe | 5 |
| 17 | Cefotaxime | 1x50 disqe | 5 |
| 18 | Augmentin | 1x50 disqe | 5 |
| 19 | Ciprofloxacin | 1x50 disqe | 5 |
| 20 | Ceftriaxone | 1x50 disqe | 5 |
| 21 | Trimethoprin | 1x50 disqe | 5 |
| 22 | Azithromycin | 1x50 disqe | 5 |

| | | | |
|----|----------------------------------|-------------|------|
| 23 | Nitrofurantoinë | 1x50 disqe | 5 |
| 24 | Ampicillin | 1x50 disqe | 5 |
| 25 | Ceftazidime | 1x50 disqe | 5 |
| 26 | Levofloxacin | 1x50 disqe | 5 |
| 27 | Doxycylin | 1x50 disqe | 5 |
| 28 | Cefazolin | 1x50 disqe | 5 |
| 29 | Clarithromycin | 1x50 disqe | 5 |
| 30 | Cefixime | 1x50 disqe | 5 |
| 31 | Nalidixic acid | 1x50 disqe | 5 |
| 32 | Norfloxacine | 1x50 disqe | 5 |
| 33 | Imipenem | 1x50 disqe | 5 |
| 34 | Oxacillin | 1x50 disqe | 5 |
| 35 | Test I shpejte HBsAg | teste | 50 |
| 36 | Test I shpejte HCV | teste | 50 |
| 37 | Test I shpejte HIV1+2 | teste | 50 |
| 38 | Test I shpejte Syphilis | teste | 50 |
| 39 | Helico bacter H.Pylori ne fece | test | 50 |
| 40 | Fece gjak akult | test | 50 |
| 41 | Tuba me kokrriza | cope | 100 |
| 42 | Tuba te thjeshta | cope | 50 |
| 43 | Tuba jeshil | cope | 50 |
| 44 | Doreza nitrili M | Pako/100 | 12 |
| 45 | Luge per peshim | | 3 |
| 46 | Disk Dispenser | Cope | 2 |
| 47 | Pambuk | Pako/100 gr | 5 |
| 48 | Alkol | liter | 5 |
| 49 | Injection plaster hypoallergenic | Pako /100 | 10 |
| 50 | Lastik per marje gjaku | Cope | 2 |
| 51 | Uje fiziologjik | liter | 2 |
| 52 | Membrane disc filter | Pjate | 4220 |

| | | | |
|----|---|--|------|
| 53 | M-ENDO AGAR LES | Pjate | 2110 |
| 54 | M-FAECAL COLIFORM AGAR | Pjate | 2110 |
| 55 | DPD nr 1(per klorin e lire) | tablet/100 | 4000 |
| 56 | Reagent per percaktimin e nitriteve (0,01-0,5mg/1 N) Nitrite LR | tablet/100 | 1000 |
| 57 | Set test per percaktimin e amoniakut (0,01- 0,08mg/1 N)te perbere: Vario ammonia salicylate F10 Vario ammonia cyanurate F10 | Set test Powder Pack/100 Powder Pack/100 | 5 |
| 58 | Set tub test per percaktimin e Nitrateve (1-30 mg/1) te perbere: 1.Vario Nitrate Chromotropic 2. Vario Nitrax Reagent tube | set tub test Powder Pack/50 reaktion tube/50 | 3 |
| 59 | Reagent per percaktimin e hekurit 0.01 – 0.5 mg/1 Fe IRON LR | Tablet / 100 | 200 |
| 60 | Reagent per percaktimin e fortesise pergjithshme(2-50 mg/1 CaCO3) Hardcheck P | tablet/100 | 200 |
| 61 | Set test per percaktimin e Aluminit (0.01-0.3 mg/1) Al te perbere : Aluminium No. 1 / No. 2 | set test Tablet / per 100 | 2 |
| 62 | Reagent percaktimin e pehashit PH(6.5-8.4) Phenol Red/ fotometer | tablet /100 | 200 |
| 63 | DPD Nr 3 | tablet /100 | 100 |

| | | | |
|----|---|--|-----|
| 64 | Set test per percaktimin e klorureve 0.5 – 25 mg/l Cl ⁻ Set CHLORIDE T1 / T2 | Set Tablet / per 100 inclusive stirring rod | 1 |
| 65 | CyA-TEST (Cyanuric acid) 0 – 160 mg/l CyA | Tablet / 100 | 100 |
| 66 | Tretesire buferike pH = 7,00 | l | 1 |
| 67 | Solucion per ruajtjen e elektrodesh- Potasium Klorur 3M KCl | ml/250 | 1 |
| 68 | Pipete 1 ml | cope | 5 |
| 69 | Pipete 25 ml | cope | 2 |
| 70 | Balon i taruar 100 ml | cope | 3 |
| 71 | Erlenmayer | cope | 6 |
| 72 | Leter filtri (për filtrimin e mostrës së ujit) | cope /100 | 100 |
| 73 | Shishe | cope | 5 |
| 74 | Xham sahati | cope | 10 |

Afat i levrimit: Brenda 30 (tridhjetë) diteve nga data e nënshkrimit të kontratës, me perjashtim të artikujve me afat skadence me të vogël se 1 (një) vit ku grafiku i levrimit do të jetë sipas kërkesave të AK. Lëvrimi do të kryhet me mjetet e operatorit ekonomik të shpallur fitues në magazinën e NJVKSH Kavaje.

Argumentimi: Sasia dhe Grafiku i levrimit janë vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 40 të VKM Nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e levrimit të mallrave.”*-

NJËSIA E PROKURIMIT